



Qendra për Politika dhe Avokim Center for Policies and Advocacy

Projekti: “Për një mjedis të pastër”

Komuna: PRIZREN

Periudha: Shtator-Dhjetor, 2009



Botues:



Qendra për Politika dhe Avokim
Center for Policies and Advocacy

Hartues të Raportit:

Tafë Veselaj dhe Aferdita Maliqi

Hulumtues në terren:

Milaim Morina
Drilon Dobruna
Valentina Hyseni
Albulena Berisha

Redaktore:

Shqipe Pantina

Mbështetur nga:



"Ky projekt u financua përmes grantit të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve."

I. Hyrje

Ambienti dhe ndotja e tij përbëjnë një ndër sfidat më të mëdha me të cilat aktualisht ballafaqohet e tërë bota, ndërkohë që një fakt i tillë vërehet me ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta klimatike (ngrohjen globale).

Kosova edhe pse nuk ka pasur një zhvillim të madh industrial, që do të kishte pasur pasoja të trashëguara për mjedisin, megjithatë ndotja e mjedisit është shumë evidente dhe një ndër problemet më të mëdha.

Problemet mjedisore janë në shumë fusha si ato të industrisë së stërvjetëruar, të ndotjes së ujërave, degradimit të natyrës dhe lumenjve, mbeturinave, ujit të pijes, shkatërrimin e pyjeve, zonave të mbrojtura etj. Edhe përkundër faktit se Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor ka nxjerr Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, gjendja në terren ka mbetur e pandryshuar apo ambienti është ndotur edhe më shumë, si pasojë e neglizhimit të kësaj problematike nga ana e autoriteteve kompetente.


Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), në raportin për Komunën e Prizrenit, pas hulumtimit që ka bërë, gjetjeve dhe debatit me përfaqësuesit e partive politike, gjatë fushatës parazgjedhore të zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009, prezanton një përmbledhje të shkurtër për gjendjen e mjedisit në këtë komunë, infrastrukturën ligjore që rregullon fushën e mjedisit, qasjen e partive politike për çështjet mjedisore dhe në fund rekomandimet që janë dalë nga tryeza e organizuar për mjedisin, të cilat kanë për synim përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Raporti është pjesë e projektit “Për një mjedis të pastër”, i cili është mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë, të cilën e falënderojmë përzemërisht. Po ashtu, QPA falënderon thellësisht përfaqësuesit e partive politike të Komunës së Prizrenit, përfaqësuesit e OJQ-vë, si dhe qytetarët, të cilët kanë kontribuar me komentet dhe rekomandimet e tyre.

Veçanërisht falënderojmë përfaqësuesit e partive politike, si Agim Muqaj kandidat për Asamble nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Naser Breca kandidat për Asamble Komunale nga “Koalicioni për Prizrenin”, Shend Kabashi kandidat për kryetar nga Partia e Drejtësisë, Halit Elshani nga Lidhja Demokratike e Kosovës – dega në Suharekë, si dhe përfaqësues të OJQ “Shpresa”.

QPA po ashtu thellësisht falënderon ata që bënë të mundur jo vetëm hartimin e këtij raporti, por edhe gjithë zbatimin e projektit “Për një mjedis të pastër”: Menaxheren e Projektit, Afërdita Maliqi, ekspertin për çështje mjedisore, Tafë Veselaj, si dhe hulumtuesit Drilon Dobruna, Milaim Morina dhe Valentina Hyseni.

II. Komuna e Prizrenit - karakteristikat dhe veçoritë



1

Prizreni shtrihet në pjesën jugore të Rafshit të Dukagjinit, në rrugën që lidhte më parë bregdetin verior të tokave shqiptare dhe qendrat e tij qytetaro- tregtare me rajonet e brendshme të Kosovës dhe të Ballkanit².

Duke zënë 5.94 % të territorit të Kosovës, Komuna e Prizrenit renditet si e dyta në Kosovë për nga sipërfaqja, me 63,986 km². Kjo komunë ka 76 vendbanime dhe ka 174.300 banorë nga të cilët në Prizren jetojnë rreth 110.000³.

Prizreni, që njihet si njëri ndër qytetet me një traditë historike, është ndër qytetet më të frekuentuara për nga numri i turistëve për shkak të trashëgimisë së shumë objekteve me karakter kulturo-historik.

¹ GIS-AMMK-MMPH

² .www.komuna-prizreni.org

³ www.institutigap.org

II.1. Gjendja aktuale në fushën e mjedisit

Ndonëse Komuna e Prizrenit nuk e ka epitetin e komunave industriale, ku niveli i ndotjes në ato komuna është dukshëm më i madh, banorët e të cilave ballafaqohen me probleme të mëdha mjedisore, megjithatë edhe Prizreni sot po përballlet me probleme të mëdha mjedisore, si pasojë e transportit dhe zgjerimit të infrastrukturës rrugore.

Vetëm në Prizren janë rreth 110.000 banorë⁴, të cilët ballafaqohen me probleme të ndryshme mjedisore nga urbanizimi i qytetit.

Mungesa e ujit të pijes, kanalizimet dhe ujërat e zeza, menaxhimi jo i mirë i mbeturinave, mungesa e riciklimit të mbeturinave, shkatërrimi i shtretërve të lumenjve nga shfrytëzimi i inertëve, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, prerja dhe dëmtimi i pyjeve, veprimet në zonat e mbrojtura të natyrës janë veprimet negative që kanë efekt në mjedisin.

Ekonomia dhe mjedisi: Ndërmarrjet shoqërore (të cilat kanë punësuar 80% të fuqisë punëtore të komunës), sektori privat që është në rritje e sipër me aktivitetet dhe veprime të ndryshme qoftë direkt apo indirekt po ndikojnë në mjedis.

Deri në mars të 2003, numri i bizneseve të regjistruara në sektorin privat është mbi 5000 (prej tyre 629 biznese prodhimi dhe zëjtari prodhuese, 357 biznese me veprimtari shërbyes dhe shërbime zëjtare, 464 biznese me veprimtari hoteliere dhe shërbime hoteliere, 325 biznese me veprimtari transporti dhe 2,254 biznese me veprimtari të tregtisë me shumicë dhe pakicë), dhe të gjitha këto biznese po ushtrojnë ndikim të theksuar në mjedis në forma të ndryshme.⁵

Zhvillimi ekonomik është i domosdoshëm për një komunë, por ato duhet të jenë në harmoni me standardet e mjedisit. Pra, ekonomia dhe mjedisi janë dy fusha të lidhura shumë me njëra tjetrën, por kërkohet kosto për standarde dhe integritet.

Uji: Prizreni është një ndër komunat më të pasura të vendit, për shkak të resurseve ujore që ka. Bistrica e Prizrenit është lumi kryesor, i cili ka ujë të mjaftueshëm, por ka edhe burime të tjera të ujit.

Megjithatë, mungesa e ujit të pijshëm është problem jo vetëm për qytetin, por edhe për fshatrat e kësaj komune. Në disa fshatra të rrethit të Hasit, nganjëherë, me javë nuk ka ujë të pijshëm.

⁴ Strategjia Zhvillimore Lokale, Prizren 2009

⁵ <http://www.komuna-prizreni.org>

Fajin për mungesë të ujit qytetarët ia lenë komunës e në veçanti ujësjellësit të qytetit “Hidrosistemi Jugor”, që fajësohet për keqmenaxhim.

Derisa nëpër fshatra, sidomos ato të anës së Hasit, banorët e sigurojnë ujin përmes puseve, banorët e qytetit varen kryekëput nga ujësjellësi. Vjetërsia e gypave të sistemit të ujësjellësit jo vetëm që humb sasi uji, por është rrezik për shëndetin e popullatës.

Mbeturinat: Në Prizren grumbullimi i organizuar i mbeturinave ka filluar që nga viti 1947. Mbeturinat grumbullohen në Deponinë Regjionale në Prizren, e cila përfshinë territorin e Prizrenit, Rahovecit, Malishevës dhe Suharekës.

Edhe në këtë deponi nuk funksionon sistemi i pompimit, gjithashtu baseni ku bëhet grumbullimi i ujërave të deponisë është çarë dhe paraqet rrezik për daljen e rrjedhës nga kontrolli, duke rrezikuar ndotjen e ujërave nëntokësore dhe banorët që jetojnë në afërsi të kësaj deponie. Presimi i mbeturinave nuk bëhet sipas rregullave nga menaxhuesit e kësaj deponie.⁶

Këtu grumbullohen të gjitha llojet e mbeturinave komunale, ndërtimore, medicinale, të automjeteve, gomat, vajrat, bateritë e hedhura dhe të shpenzuara. Por, ajo që është pozitive në këtë komunë është se nuk ka të regjistruara mbeturina industriale të rrezikshme.⁷

Bujqësia dhe blegtoaria: Mbeten akoma ndër burimet e rëndësishme të punësimit dhe jetesës, sepse për më shumë se 50 për qind e popullatës jeton në mjediset rurale. Prizreni është i njohur për pemët, perimet, verën dhe përpunimin e prodhimin e produkteve prej qumështi (4 qumështore).

Aktualisht ujiten 25 % të tokës punuese respektivisht 3,300 ha. Ujitja bëhet përmes tri hidro-sistemeve: Dukagjinit, Radoniqit dhe sistemit lokal të ujitjes.

Mbrojtja e natyrës: Në kuadër të Komunës së Prizrenit mbrojtja e natyrës⁸ identifikohet me mbrojtjen e Parkut Kombëtar “Mali Sharr” me sipërfaqe 39.000 ha, i cili në kuadër të kësaj komune zë sipërfaqen prej 19.500 ha. Për shkak të pasurisë së madhe të vlerave natyrore kjo zonë është me interes kombëtar.

Mirëpo, edhe këtu është evident ndikimi i njeriut përmes aktiviteteve të ndryshme siç janë: urbanizimi i Prevallës, prerja e pyjeve, gjuetia e parregullt e kafshëve të egra, zhvillimi i aktiviteteve turistike rekreative në mënyre jo të qëndrueshme, të cilat dukuri kanë ndikim të theksuar në vlerat e këtij territori.

⁶ Gjendja e mbeturinave në Kosovë 2008, AKMM Prishtinë

⁷ Gjendja e mbeturinave në Kosovë, MMPH 2005

⁸ Raport i gjendjes së Natyrës, AKMM, 2009

Ekzistojnë edhe monumente të tjera të mbrojtura natyrore me karakter botanik, hidrologjik siç janë: Rrapi në Marash, Gryka e Bistricës së Prizrenit etj.

Një numër i madh monumentesh historike e bëjnë Prizrenin lokacion shumë atraktiv si për vizitorët e huaj ashtu edhe ata nga Kosova. Trashëgimia historike e Prizrenit jo vetëm që i tërheq turistët nga mbarë Kosova, por edhe ata të huaj.

Rëndësi të madhe për zhvillimin e turizmit malor ka edhe Parku Kombëtar “Mali Sharr”. Prevalla është një prej qendrave mjaftë atraktive për turizëm, rekreacion, sport, çlodhje si dhe për kurimin e shumë sëmundjeve.

II.2. Infrastruktura ligjore në fushën e mjedisit

Kuvendi i Kosovës deri më sot ka miratuar ligje që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës dhe ato që ndërlidhen me ndikimet në mjedis. Pothuaj se janë 32 ligje të tilla të miratuara që prekin këtë fushë, por ligjet më të rëndësishme për mjedisin që zbatohen në Komunën e Prizrenit janë:

- Ligji për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji për ujërat e Kosovës
- Ligji për mbeturinat
- Ligji për vetëqeverisje lokale
- Ligji për mbrojtjen e natyrës
- Ligji për planifikimin hapësinor
- Ligji për pyjet e Kosovës
- Ligji për Parkun Nacional “Mali Sharr”
- Ligji për gjuetinë
- Ligji për peshkatari dhe akuakulturë, etj.

Si dokument më i lartë i Komunës, ku janë të vendosura të gjitha përgjegjësitë, e një ndër to edhe mbrojtja e mjedisit, është Statuti i Komunës së Prizrenit. Neni 19 i Statutit përfshin edhe mbrojtjen e mjedisit në Komunë.⁹

Gjithashtu, nga ana e Kuvendit Komunal është miratuar Strategjia zhvillimore lokale (2009), pastaj Rregullorja për tarifën, ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale (Qershor 2009).

⁹http://www.komuna-prizreni.org/repository/docs/Statuti_i_Komunes.pdf

II.3. Institucionet përgjegjëse dhe mekanizmat për mbrojtjen e mjedisit

Asambleja Komunale e Prizrenit si institucion më i lartë përbëhet nga 11 drejtori. Ne kuadër të Drejtorisë së shërbimeve publike vepron Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave.

Gjithashtu, kontribut japin edhe: Drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural, ajo për Urbanizim dhe planifikim hapësinor, Inspektorati komunal, etj.

Ndërkohë, me Parkun Kombëtar “Mali Sharr” menaxhon Dejtoria e parkut, që është në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila drejtori është përgjegjëse për ruajtjen dhe mbrojtjen e Parkut “Mali Sharr”.

Pos institucioneve qeveritare lokale edhe shoqëria civile në këtë komunë është mjaft aktive në mbrojtjen e mjedisit, si p.sh., Shoqata për ruajtjen e zogjve “ Finch”, “Eco99” etj.

III. Platformat politike të partive politike për çështjen e mjedisit

Prizreni, si një qytet me një traditë të lashtë dhe një ndër qytetet më të vizituara nga turistët, domosdo për të tërhequr vizitorët dhe për të qenë një qytet me vlera të larta kulturore, si prioritet duhet ta ketë pikë së pari një ambient të pastër e të shëndosh.

Qendra për Politika dhe Avokim, më 24 tetor 2009, ka organizuar një debat në Prizren me përfaqësuesit e partive politike, që garojnë në zgjedhjet e 15 nëntorit 2009, të cilat kanë shpalosur objektivat, planet, prioritetet dhe premtimet e tyre për përmirësimin e mjedisit.

Partitë politike ndonëse e dinë rëndësinë që ka ambienti megjithatë disa nga to nuk kanë prezantuar programe konkrete për zgjidhjen e problemeve ambientale që preokupon qytetarët.

Ndonëse në debatin e organizuar nga QPA nuk ka marrë pjesë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, megjithatë në platformën e saj politike shihet një vështrim më i thuktë rreth problemeve ambientale, e një gjë e tillë vërehet edhe te platforma e LDK-së.

a) Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në debat është përfaqësuar nga z.Agim Muqaj, kandidat për Asamble Komunale, i cili ka thënë se LDK ka në prioritetet e veta çështjen e mjedisit, e sidomos në zgjidhjen e problemeve mjedisore që tashmë po rëndojnë banorët e kësaj komune.

Ai derisa ka prezantuar platformën për mjedis ceku edhe disa nga faktorët e ndotjes së mjedisit, që, sipas tij, janë: rritja demografike e popullsisë, ndërtimi i vendbanimeve të reja dhe deponitë e vjetëruara të mbeturinave.

Sipas tij, LDK do të angazhohet në ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimin e qytetarëve për mjedis, mbrojtjen e diversitetit, shtimin e hapësirave të gjelbëruara, mbrojtjen e lumenjve nga ndotja dhe degradimi, menaxhimin më të mirë me mbeturinat, riciklimin dhe selektimin e mbeturinave, ndërtimi i një impianti për përpunimin e ujërave të zeza.

Po ashtu, Muqaj ka rekomanduar edhe formimin e një Drejtorie për mjedis, inspektive më efektive për mjedis, si dhe rregullimin e kaskadave në Lumbardh.

b) Koalicioni për Prizrenin (LDD, AKR, BALLI KOMBËTAR, PSDAK dhe BUK) në debat është përfaqësuar nga z. Naser Bresa, i cili paraqiti problemet ekzistuese të mjedisit në komunë.

Si fusha me problematike të mjedisit ai konsideroi; degradimin e resurseve natyrore (lumenjve dhe pyjet), ujin e pijes, keqmenaxhimin me mbeturinat, industrinë e lëngjeve dhe stiroporit, gurëthyesit dhe seperacionet.

Por, ai tha se ndër prioritetet e këtij Koalicioni për këtë fushë janë: menaxhimi më i mirë me ujë të pijes, si dhe resurset natyrore, mbrojtja dhe mirëmbajtja e lumenjve, menaxhimi i mbeturinave, ndërkohë që ka cekur se ky koalicion do të ketë prioritet edhe bashkëpunimin me shoqërinë civile në çështjet mjedisore.

c) Partia e Drejtësisë është përfaqësuar nga z. Shend Kabashi, i cili potencoi më qartazi problemet mjedisore që janë evidente në komunë. Ndër problemet mjedisore të paraqitura nga z. Kabashi ishin uji i pijshëm, keqmenaxhimi me mbeturinat, erozioni i tokës, degradimi i natyrës, biodiversiteti dhe shumë elemente tjera negative me ndikim në mjedis.

Kabashi ka qenë më konkret rreth problemeve mjedisore, por edhe mënyrës së zgjidhjes së tyre. Ai si prioritet ka paraparë ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza, ruajtjen dhe mbrojtjen e lumenjve, menaxhimin me mbeturinat dhe riciklimin e tyre, hartimin e një rregulloreje për parandalimin e ndërtimeve të egra, si dhe përmirësimin e gjendjes me ujin e pijshëm.

Në debatin “Për një mjedis të pastër” ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i OJQ “Shpresa Jonë”, z. Sadik Shala. Nga perspektiva e shoqërisë civile, Shala tha se në Komunën e Prizrenit kemi rritje të vazhdueshme të ndotjes së mjedisit, ndërkajshëm si probleme akute përmendi keqmenaxhimin me urbanizmin e qytetit, flora dhe fauna që për çdo ditë rrezikohen nga zhdukja, mbeturinat, ujin e pijes etj.

Shala ka rekomanduar që sa më parë të ndërpritet ndotja e mjedisit, të bëhet planifikimi më i mirë urbanistik i qytetit, etj.

IV. Rekomandimet

Rekomandimet e dala nga tryeza “Për një mjedis të pastër”:

- Impiant për trajtimin e ujërave të përdorura.
- Riciklimi dhe përpunimi i mbeturinave urbane.
- Burime alternative për mjedis.
- Formimi i Drejtorisë për mjedis.
- Industria-funksionimi sipas standardeve të BE-së për ndotje.
- Investim në zhvillimin e resurseve njerëzore.
- Edukimi dhe specializimi i kuadrove të reja mjedisore.
- Aprovimi i ligjeve prioritare mjedisore dhe implementimi efikas i atyre.
- Promovimi i marrjes së përgjegjësisë të plota nga ana e komunave për problemet mjedisore.
- Rritja e qasjes së qytetarëve në shërbimet publike jetësore që ndikojnë në shëndet dhe mjedis.
- Promovimi i eko-turizmit dhe turizmit dimëror.
- Fushatë permanente për vetëdijesimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit.
- Të bëhet gjelbërimi i sipërfaqeve të tokës në Komunën e Prizrenit.
- Të respektohet Ligji për mbrojtjen e natyrës (për mbrojtjen e florës dhe faunës).
- Mbrojtja e mjedisit të futet si lëndë mësimore në shkolla.
- Industria të funksionojë në bazë të standardeve të përcaktuar për ndotje.
- Definimi i kufirit të qytetit me vendet rurale.
- Të vendosen kritere strikte për prerjen e pyjeve.

Të bashkangjitur:

Aneski 1: Platformat politike

1.1 PLATFORMA POLITIKE E ALENACËS PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS

Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor

Kosova me një territor relativisht të vogël, karakterizohet me vlera jashtëzakonisht të larta të natyrës (Bjeshkët e Nemuna, Sharri, Ujëvarat e Mirushës, Shpella e Gadimës etj), si dhe resurse të bollshme natyrore xehe plumbi, zinku, hekuri, nikeli, lignit etj).

E kaluara e Kosovës e diktuar kryesisht nga interesat e të tjerëve është shënuar me një eksploatim të egër të këtyre resurseve, pa asnjë përkujdesje për pasojat mbi mjedisin (këtë e ilustron eksploatimi i xeheve në Trepçë dhe i resurseve të linjtit në zonën e Kastriotit/Obiliqit).

Si pasojë karakterizohet me një situatë të rëndë mjedisore, me disa pika të nxehta (*hot-spots*) të ndotjes (Mitrovicë, Drenas, Obiliq, Hani i Elezit etj) së ajrit, ujit, tokës (përfshirë edhe humbje të sipërfaqes së tokave bujqësore).

Një zhvillim ekonomik të Kosovës, duke marrë parasysh edhe dy shtyllat tjera të zhvillimit të qëndrueshëm: nevojat sociale dhe implikimet mjedisore në këtë territor të vogël, të bukur por edhe të ngarkuar me ndotje nga e kaluara.

Prioritet do tu jepet përmirësimit urgjent të shërbimeve vitale jetësore që ndikojnë në shëndetin e popullatës: ujit të sigurt të pijes, qasjes në kanalizim dhe trajtim të mbeturinave. Aktivitetet strategjike që AAK synon të ndërmerr:

1. Investim në zhvillimin e resurseve njerëzore për ballafaqim me sfidat mjedisore nga e kaluara (me prioritet ndotja në rajonin e Trepçës dhe zonën e KEK-ut si dhe ndotjen aktuale nga Ferronikeli) përmes:
 - a. Edukimit dhe specializimit të kuadrove të reja mjedisore;
 - b. Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore;
 - c. Aplikimi i teknologjive të pastra në sektorin e që kanë ndikim në mjedis;
 - d. Instalimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza gjatë shkarkimit të tyre nga aktivitetet e ndryshme industriale;
 - e. Ngritja e sistemit monitorues të ajrit, ujit dhe tokës për industrinë e caktuar;

2. Ristrukturimi i institucioneve ekzistuese mjedisore në aspektin e menaxhimit efikas, me fokus në ndarjen e qartë të përgjegjësisë në mes tyre (Ministri, Agjenci ekzekutive, inspektoratit dhe institutet profesionale) dhe prioritet në rritjen e investimeve, modernizimin e shërbimeve dhe efektivitetit në punë;
3. Aprovimi i ligjeve prioritare mjedisore dhe implementimi efikas i atyre ekzistues në trend të përafrimit gradual me kërkesat e legjislacionit të BE. Nxjerrja urgjente e standardeve nacionale të ndotjes si “urë kaluese” drejt atyre të BE-s.

Kontrolli i plotë i procesit të dhënies së lejeve mjedisore sidomos në sektorin e industrisë, energjisë dhe transportit.

4. Promovimi i marrjes së përgjegjësisë të plota nga ana e komunave për problemet mjedisore në territorin e tyre, në kuadrin e legjislacionit ekzistues për mbrojtjen e ujit, tokës, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura si dhe menaxhimin e mbeturinave.
5. Sigurimi i mjeteve financiare për investime në mjedis nga vet ndotësit: aplikimi i parimit “ndotësi dhe shfrytëzuesi paguan-polluter and user pays”, aplikimi i taksave minimale në lëndët ndotëse (derivatet), dhe përkrahja ligjore e nismave ekonomike për teknologjitë e pastra investive;
6. Zhvillimi i sektorit energjetik dhe i industrisë bazuar në nevojat reale duke zbatuar parimet e vlerësimit të ndikimeve sociale dhe mjedisore në përputhje me standardet mjedisore.
7. Rritja e qasjes së qytetarëve në shërbimet publike jetësore që ndikojnë në shëndet dhe mjedis: ujë të pijes, kanalizim dhe trajtim të mbeturinave. Promovimi i investimeve në fushën e trajtimit të ujërave të zeza dhe riciklimit të mbeturinave;
8. Promovimi i eko-turizmit dhe turizmit dimëror në dy parqet nacionale: Sharr dhe Bjeshkët e Nemuna; dhe promovimit të vlerave unike të rajonit: Ujëvarave të Mirushës dhe Shpellës së Gadimes për tërheqjen e turistëve nga jashtë. Këto 4 zona të jenë shenja dalluese për Kosovën në botë.
9. Një fushatë permanente për vetëdijesimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit përcjell sidomos me punën edukative me gjeneratat e reja si dhe marrjen e pronësisë nga komuniteti për mjedisin e tyre. Risetimi i kampanjës kombëtare “Kosova-shtëpia ime”.

1.2 PLATFORMA E LIDHJES DEMOKRATIKE E KOSOVËS

Sektori i Ambientit

Ky segment ndoshta është edhe sektori që do të ketë vëmendje të veçantë pasi edhe lidhet me shumë qeshtje nderlidhëse me kohën që pason e ku Kosova do të investon veqanarisht në periudhën e ardhshme.

Si nderlidhje është edhe kërkesa nga EU që Kosova duhet të investon në Ambient që është njëri prej kushteve kryesore për praninë në këtë mekanizëm të rendesishëm, krijimi i ambientit me të mirë për qytetar, ngritja e nivelit higjienik në të gjithë Komunën dhe Brenda qytetit ku shërbimet komunale duhet të funksionojnë me ndryshe dhe adaptimi i ambientit me investimet e përgjithshme që janë bërë der më tani.

Të gjitha investimet të cilat do të bëhen paraprakisht do të bëhen në konsultime të përgjithshme me ekspert të kësaj lëmie dhe do të ketë takime me qytetar për të cileve drejtpërdrejt do të shihen nevojat kryesore të tyre.

- Menaxhimi dhe riciklimi i mbeturinave në zonën urbane dhe rurale;
- Përmirësimi i Ujësjellësit;
- Ndërtimi i impiantit dhe trajtimi i ujërave të zeza;
- Hulumtimi i kapacitetit të burimeve alternative të energjisë elektrike si uji, mullinjtë e erës;
- Ndërtimi i hidrocentralit të Zhurit;
- Organizimi i strukturës menaxhuese dhe financuese për rregullimin e sistemit të ujitjes;
- Zhvillimi i potencialit ekonomik në zonat e trashëgimisë kulturore dhe burimeve natyrore për turizëm dhe rekreacional.
- Valorizimi i burimeve natyrore kryesisht Parku Nacional Malet e Sharrit

Prizren, 24 tetor 2009



Projekti “Për një mjedis të pastër” i mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë



Projekti “Për një mjedis të pastër” i mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë